AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional**

**"Teknik Imazherie"**

**ofruar nga**

**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani"**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Altina Xhaferi
2. Gjok Tosku

Qershor 2023

**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Për Programin e studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Aleksander Xhuvani"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Aleksander Xhuvani" |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Departamenti i Lendeve Klinike |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bsc në Imazheri |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | - VKM Nr. 621, datë 5.10.2018 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | - Urdhër nr.175, datë 24.06.2019 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i dyte |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 1 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 60 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Gjuha shqipe |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 7 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 12 PAE / 30 PAK |
| 18 | Numri i studentëve: | v.a (2020-2021) 18 studentë<br>v.a (2021-2022) 23 studentë<br>v.a (2022-2023) 24 studentë |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti Elbasanit "Aleksander Xhuvani " (UE) është institucion publik i arsimit të lartë, hapur me VKM Nr. 414 datë 12.11.1991, me statusin Universitet i Elbasanit Aleksader Xhuvani.

Universiteti i Elbasanit është vazhdues i Institutit te Lartë Pedagogjik "Aleksander Xhuvani" (ELP) themeluar më 1971, i cili u përvijua si vazhdues i drejtpërdrejtë i Shkolles Normale të Elbasani. Universiteti i Elbasanit "Aleksander Xhuvani" organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Per arsimin e larte dhe kerkimin shkencor ne institucionet e arsimit te larte ne Republiken e Shqiperise", aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.

Struktura akademike e Universitetit të Elbasanit, aktualisht përbëhet nga këto njësi kryesore:

1. Fakulteti i Shkencave të Natyrës;
2. Fakulteti i Shkencave Humane;
3. Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike;
4. Fakulteti i Shkencave të Edukimit;
5. Fakulteti ekonomik;

Programi i studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" është hapur me Urdhër të MASR Urdhër nr.175, datë 24.06.2019 me formë studimi me kohë të plotë, 60 kredite dhe kohëzgjatje 1 vit akademik. Programi ofrohet nga Departamenti Lëndëve Klinike, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike. Në shqyrtim të aktivitetit të zhvilluar vitet e fundit, GVJ konstaton që PS Master profesionale në "Teknik Imazherie" ka rezultate të prekshme në cilësinë e përgatitjes së studentëve duke u dhënë atyre aftësi për të konkretizuar njohuri teknike imazherike në përgjithësi, aftësi për të vetvepruar në kuadrin e organizimit e kryerjes së punëve zbatuese në ambjentet spitalore, aftësi për të marrë përsipër përgjegjësi profesionale e etike, aftësi për të komunikuar në terma profesionalë, aftësi për të kërkuar zgjidhje duke u konsultuar me përvojën e kolegëve dhe literaturën
profesionale,
aftësi në menaxhimin e problematikave të ndryshme, njohjen e standarteve dhe metodologjive bashkëkohore. Në të gjitha takimet, por veçanërisht në takimin me studentët, GVJ mësoi që transmetimi i dijeve në kuadrin e këtij PS realizohet me synime të qarta që të diplomuarit e tij të jenë jo vetëm të kërkuar në tregun e punës vendas e të huaj por edhe të realizojnë ambicje të guximshme për të vazhduar studimet e thelluara në ciklet e studimeve Doktoratë. Në përfundim të këtij aktiviteti GVJ konstatoi që PS Master Profesional në "Teknik Imazherie" zhvillohet si një program i suksesshëm studimi, në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar, me një infrastrukturë mësimore që përmbush më së miri kërkesat e studentëve dhe mbështet në standardet bashkëkohore përpjekjet dhe arritjet e personelit në aktivitetin mësimor dhe punën kërkimore-shkencore me studentët. Vetë plani mësimor dhe programet e lëndëve janë profilizuar tashmë në ofertën e dijeve që i çon natyrshëm studentët si tek vazhdimi i cikleve më të larta të diplomimit ashtu edhe tek tregu i punës.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm të programit të studimit MP në "Teknik Imazherie" filloi me ngritjen e grupit të vlerësimit të jashtëm (GVJ). ASCAL, bazuar në "*Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017*", ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga IAL, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Dr. Altina Xhaferi, dhe Dr. Gjok Tosku. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga kordinatoria teknike e ASCAL, Znj.Rajna Lila.

Grupi u njoh dhe studjoi dosjen e vetvlerësimit duke u ndalur posaçërisht tek Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (RVB). Njohja dhe studimi i dosjes çoi në formulimin e pyetjeve që lidhen me nevojën për qartësimin e gjetjeve në RVB, saktësimin e vlerësimeve, plotësimin e informacioneve dhe konkretizimin e paraqitjeve. Për të realizuar këto objektiva, GVJ u njoh më së pari me axhendën e vizitës në institucion. Vizita u realizua me daten 26 Janar 2023. Gjatë vizitës, GVJ zhvilloi takime me Shefin e Departamentit të PS Master professional në "Teknik Imazherie", grupin e vetvlerësimit, stafin akademik, studentët, njësinë bazë të sigurimit të cilësisë, përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Planifikimit të Karierës, sekretarisë mësimore. Gjithashtu GVJ vizitoi dhe mjediset mësimore, social kulturore e laboratorike ku zhvillohet programi i studimeve Master Profesional në "Teknik Imazherie". Në këto takime GVJ u njoh më nga afër me nivelin e plotësimit të standarteve të kërkuara në ofertën e programit, organizimin, drejtimin dhe administrimin e tij, mësimdhënien, mësimnxënien dhe ushtrimin e kompetencave, burimet financiare, infrastrukturën, logjistikën për realizimin e PS Master Profesional në "Teknik Imazherie". trajtimin e studentëve dhe gjithë mbështetjen për to si dhe punën që bëhej për sigurimin e cilësisë.

Mbështetur në dokumentacionin bazë të sistemuar në dosjen e vetvlerësimit, informacionet e marra, plotësimet, saktësimet si dhe gjetjet konkrete, GVJ formatoi gjithë bazën e nevojshme dhe të domosdoshme të të dhënave për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm (RVJ).

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Teknik Imazherie"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1<br>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti Elbasanit synon arritjen e standardeve më të larta akademike, mbështetjen e aspiratave arsimore dhe arritjet e të gjithëve, promovimin e zhvillimit kërkimor-shkencor, përgatitjen e specialistëve të lartë në fushën e mjeksisë. Institucioni ofron program studimi që është në përputhje me interesat kombëtare dhe institucioneve politikëbërëse në fushën e mjekësisë.<br><br>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konkludon që PS i ofruar nga IAL mbështetet dhe mbron vlerat kombëtare. Referuar statutit, programet e studimit të ofruara nga UE synojnë përgatitjen e profesionistëve në fushat respektive sipas programeve të studimit dhe janë në përputhje me misionin dhe objektivat e UE. Këto programe jo vetëm që tentojnë të ruajnë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare, por synojnë edhe zhvillimin dhe promovimin e mëtejshëm të tyre.<br><br>*(Statusi i UE)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | UE ofron programe në disa prej fushave kryesore duke synuar përgatitjen e specialistëve të shëndetit me qëllim ofrimin sa më cilësor të shërbimit ndaj pacientit dhe edukimin e tyre ne vazhdim në përputhje me trendet e zhvillimit bashkëkohor. Programi MP në Teknik Imazherie ofron një mundësi formimi për studentët në fushën e imazherisë si pjesë e rëndësishme e kujdesit mjekësor.<br>*(statuti i UE)* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit. | Programi i studimit MP në Teknik Imazherie, synon në formimin e shprehive të profesionit duke i dhënë studentit autonominë e nevojshme në realizimin e detyrës dhe fuksioneve të tij të përcaktuara nga profili profesional në drejtim të kujdesit shendetësor në popullatë. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit | Programi i studimit Master profesional në Teknik imazherie është hartuar dhe është zhvilluar në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtarsi dhe prirjeve globale të zhvillimit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | *(statuti i UE)* | | | |
| **Konkluzione** | *Universiteti i Elbasanit ofron program studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, dhe synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Programi i studimit Master professional në Teknik Imazherie, ofrohet nga Departamenti i Lëndëve klinike si pjesë e Fakultetit të Shkencave mjekësore teknike i cili ka përvojë dhe kapacitetë akademike dhe fizike për realizimin e këtij program studimi |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Mbështetur në Rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore si dhe në rregulloren e Departamentit përgjegjës për këtë PS, mund të thuhet se fusha e përgjithshme e programit të studimit është në përputhje më fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë dhe asaj kryesore<br><br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.14* |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Bazuar në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit si dhe udhëzimeve kombëtare e europiane gjykohet se fusha e përgjithshme e programit të masterit profesional në Teknik Imazherie është në përputhje me fushën akademike e kërkimore shkencore të Departametit të lëndëve Klinike i cili e ofron këtë program. Istitucioni realizon bashkëpunime edhe me intitucione shëndetësore për të siguruar kërkimin shkencor.<br><br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.9, 1.11* |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Nuk aplikohet si kriter<br><br>RVB |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | Institucioni ofron trajnime profesionale mbështëtur në marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e ndryshme shëndetësore.<br><br>*Evidenca 1.13, 1.29* |
| **Konkluzione** | *GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Për përmbushjen e këtij kriteri GVJ konsultoi RVB si dhe mori informacione plotësuese gjatë vizitës në institucion. GVJ konstaton që Universiteti i Elbasanit ka marrëdhënie të mbështetura në akte ligjore e nënligjore me të gjitha njësitë kryesore e ato bazë brenda institucionit duke siguruar një bashkëpunim funksionues. Njësitë bazë të këtij institucioni, ndër to edhe Departamenti i Lëndëve Klinike, organizojnë veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore në koordinim të plotë më njësitë kryesore. Bashkëpunimi është i njehsueshëm në aktivitetet e promovimit të institucionit, në koordinimin e trajnimeve, objektivat për rritjen e cilësisë së botimeve shkencore si dhe në përdorimin e ambienteve të përbashkëta. GVJ konstaton që ky bashkëpunim është i qëndrueshëm dhe efikas. |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Përveç gjetjeve në RVB lidhur me bashkëpunimin e institucionit me institucione homologe brenda e jashtë vendit si dhe shërbimet mjekësore vendase e të huaj në realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve, GVJ u informua konkretisht edhe gjatë takimit me përfaqësuesit e Departamentit të lëndëve Klinike dhe Drejtorinë e Kordinimit të marrëdhënieve me Jashtë ku mësoi se kjo zyrë ka funksion koordinues për projektet duke u fokusuar si në projektet e brendshme ashtu edhe në ato të jashtme. Referuar dokumentacioneve:<br><br>*RVB, Evidenca 1.11 dhe 1.13 dhe 1.14* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute | Universiteti Elbasanit ka nënshkruar një sërë marëveshje në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje me institucionet spitalore apo struktura të posacme të cilat |

| | |
|---|---|
| kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | shërbejnë si për realizimin e praktikave profesionale ashtu edhe për punësimin e studentëve të diplomuar.<br><br>*Tabelat RVB, evidencës 1.13 dhe 1.14* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Referuar RVB cdo vit akademik, institucioni dhe njësitë bazë kryejnë analizën e punës dhe rezultatet e bashkëpunimit një pjesë e të cilave janë bërë publike në raportet vjetore të fakultetit dhe universitetit. Vihet re numër konstant te studentëve të regjistruar në këtë program vit pas viti megjithëse kërkesat dhe kapacitetet pritëse janë më të larta.<br><br>*(Tabelat RVB MP ne TI. Takimi me sekretarine mësimore, Evidenca 1.20, 1.29)* |
| **Konkluzione** | *GVJ për tu shprehur në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, bën një përmbledhje të shkurtër bazuar në gjetjet e evidentuara në pjesën përshkrimore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". është i strukturuar në 1 vit akademik, organizuar në 2 semestra. Zhvillohen gjithsej 32 module përkatëse të ndara përkatësisht 20 module në semestrin e parë dhe 12 module në semestrin e dytë ku është e përfshirë edhe punimi i diplomës (mikorteza), si edhe praktika profesionale. Lëndë të detyrueshme janë 31, dhe lëndë me zgjedhje janë 1. Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E).<br><br>Duke iu referuar kurrikulës së programit të studimit dhe rregullores vërehet që programi i studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". është organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Një semestër i rregullt përmban deri 30 ECTS. Bazuar në Rregulloren e organizimi të programit të studimit, kreditet ECTS të çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përllogariten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore punë e studentit, ku futen orë mësimore në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë pune individuale të studentit.<br><br>*(Plani mesimor MP ne TI evidenca 3.12.)*<br><br>*(Rregullore e programit te studimit)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një | Programi i studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" jep njohuritë themelore në lëndët e formimit bazë të cilat shërbejnë për formimin e përgjithshëm si profesional ashtu edhe akademik. Këto lëndë janë shpërndarë kryesisht në vitin e parë akademik. Më tej lëndët e tjera të formimit profesional shërbejnë për thellimin e kompetencave profesionale të studentit aktual por edhe të profesionistit të ardhshëm. Në vlerësimin e syllabuseve të lendëve profesionale vihen re zhvillim me kompetencë i temave të ndryshme të cilat do të shërbejnë në rritjen e aftësisë së profesionistit të ardhshëm për të zgjidhur probleme të ndryshme në fushën e dhënies së shërbimit të tij specifik.<br><br>Lëndët e parashikuara që zhvillohen në programin e studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie", janë gjithëpërfshirëse duke filluar |

| | |
|---|---|
| fushë të specializuar studimi ose profesionale. | nga ato te formimit të përgjithshëm si menaxhin Shënëndetësor dhe Legjislacion dhe më pas duke u thelluar përgjatë semestreve në Protokollet e Ct, MRi apo urgjencava të cilat synojnë të japin shprehi e nocione të avancuara të fushës.<br><br>Bazuar në planin mësimor, si edhe në programet e lëndëve mund të arrihet në përfundimin se programi i studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". siguron formimin e shprehive të veçanta në fushën e teknikave Radiologjike.<br><br>*(Plani mesimor evidenca 3.12)*<br><br>*(Syllabuset e lëndëve evidence 1.33* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) lëndët janë ndarë në pesë kategori (A, B, C, D, E). Bazuar në kreditet përkatëse lëndët e kategorive të ndryshme kanë këtë shpërndarje:<br>▪ kategoria A – 15%<br>▪ kategoria B – 42%<br>▪ kategoria C – 13.3%<br>▪ kategoria D – 10 %<br>▪ kategoria E – 20 %<br><br>Bazuar në (VKM 879, datë 18.12.2019) shpërndarja e lëndëve është e rregullt vetëm për kategorinë D dhe rezulton më e lartë për kategorinë A, B dhe E dhe më e ulët për kategorinë C.<br><br>*(Plani mesimor, evidence 3.12.)* |
| **Kriteri 4.** Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | Nuk aplikohet si kriter<br><br>RVB |
| **Kriteri 5.** Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | Nuk aplikohet si kriter<br><br>RVB |
| **Kriteri 6.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe | Pranimi i studentëve bëhet duke u bazuar ne ligjin e arsimit të lartë nëpërmjet rankimit të studentëve aplikantë në bazë të mesatares së |

| | |
|---|---|
| financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | studimeve të bachelorit. Financimi i studentëve bëhet nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit apo bursave. Pranimi i studnetëve dhe financimi i studimeve mbështetet në ligjin e arsimit të lartë. |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programet e studimit Master Profesional, që ofrohet nga Universiteti i Elbasanit ka ngjashmëri në përmbajtje së paku 70 për qind me programet e tjera të studimit të ofruara nga disa universitete të tjera të arsimit publik apo privat. |
| **Kriteri 8.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës sipas vendimit Nr 2655/3 dt 24.06.2019 I cili e kodifikon programin sipas fushës së studimit<br><br>*Evidenca 1.26, 1.9* |
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | Ky institucion nuk ofron programe të përmbashkëta me institucione të tjera të arsimit të lartë si brenda ashtu edhe jashtë vendit. |
| **Konkluzione** | *Bazuar në legjislacionin kombëtar në fuqi (VKM 879, datë 18.12.2019) rubrika e masterit Profesional, programi i studimit ka nevojë për rregullimin e duhur të kategorive të ndryshme (A, B, C, D, E)* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Departamenti i Lëndëve Klinike është pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. Fakulteti ka në përbërje të tij 40 pedagogë Efektivë (PAE) dhe 127 pedagogë me kontratë (PAK), ndërsa Departamenti i Lëndëve Klinike ka 42 pedagoge ku 12 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 30 janë pedagogë me kontratë (PAK). Nga këto 1 pedagog është me titullin Profesor, 4 janë me gradën shkencore Doktor Shkencash, 3 |

| | |
|---|---|
| | pedagogë janë në process për fitimin e gradës shkencore Doktor shkencash.<br><br>Nga sa më sipër rezulton se njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbushin detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.<br><br>Departamenti I lëndëve Klinike është njësia bazë përgjegjëse për programin Master Profesional në "Teknik Imazherie". dhe I përmbush detyrimet ligjore për vlerësim dhe akreditim.<br><br>*Evidenca 1.17, 1.18* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Praktikat profesionale për studentët e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". koordinohen nga përgjegjësi i njësisë bazë dhe koordinatori akademik. Njësia bazë përcakton një koordinator të ndjekjes së praktikave profesionale. Koordinimi i praktikave bëhet në Insitucionet shëndetësore me të cilat Universiteti i Elbasanit ka kontrata bashkëpunimi përkatësisht në Poliklinikën e Specialiteteve, Spitali i Elbasanit, sherbimi i kirurgjisë, Urgjencë etj Njësia bazë angazhon personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore dhe laboratorike.<br><br>*Evidenca 1.7; 1.13; 1.18* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Gjatë vizitës së GVJ në Institucion dhe vlerësimit të dokumentacionit, u konfirmua se programi i studimit ka një kordinator i cili siguron mbarëvajtjen e programit mësimor. Koordinatori didaktik (përgjegjësi i programit) është paracaktuar të bëjë veprimtari që kërkojnë aftësi bashkëpunuese dhe komunikuese për të menaxhuar lidhjet midis subjekteve të brendshme dhe të jashtme të përfshirë në procesin mësimor. Koordinatori i programit merret me evidentimin e problemeve të studentëve në të gjitha vitet e studimit akademik, koordinon punën për krijimin e formateve të syllabuseve, oraret mësimore si dhe vë në dijeni stafin pedagogjik në lidhje me to. Gjithashtu reflekton shqetësimet e ngritura nga stafi akademik në lidhje me përmirësimin e syllabuseve apo planit studimor. Ai shërben si urë lidhëse mes përgjegjësit të departamentit dhe stafit akademik si dhe studentëve.<br><br>*Evidenca 1.23* |
| **Konkluzione** | *Njësia bazë përmbush standartet për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. Njësia bazë ka angazhuar personel ndihmës akademik për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike si dhe ka caktuar një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.3<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Referuar dosjes së vetëvlerësimit, vizitës në institucion, GVJ konstaton se Departamenti i Lëndëve Klinike dhe FSHMT zotërojnë informacionet e nevojshme për organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". Si pjesë të këtij informacioni mund të përmendim që nga plani strategjik i programit të studimit, statuti i universitetit, rregullorja e universitetit, rregullorja e fakultetit, rregullorja e diplomimit e deri tek rregulloret e sekretarisë dhe zyrës së burimeve njerëzore. Informacionet janë të publikuara në faqen e internetit të Universitetit dhe të aksesueshme nga të gjithë.<br>*(Plani mësimor, rregullorja e programit; syllabuset e lëndëve; CV e personelit)* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Nga shqyrtimi i Planit mësimor të programit të studimit, GVJ konstatoi se në planin mësimor të programit janë të pasqyruara informacionet lidhur me ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit. Në rregulloren e programit si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm për frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj.<br>Konkretisht në përgjithësi mënyra e vlerësimit të lëndës është si më poshtë:<br>10 pikë -Aktivizimi (Aktivizimi në orët mësimore, detyrat e kursit, etj.)<br>10-20 pikë – Provimi ndërmjetëm;<br>10 pikë – Laboratorë;<br>60 – 80 pikë -- Provimi Përfundimtar;<br>Ndarja në rubrikat e mësipërme është formuluar duke u bazuar në objektivat e lëndëve përkatëse<br>*Evidenca 3.17* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Të gjithë kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në programin e Studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie". duhet të plotësojnë përkatësisht kriteret e pranimit, të ndjekin procedurat e regjistrimit dhe plotësojnë dokumentacionin. UE ofron mundësi për transferime në hyrje dhe në dalje të studentëve. Me urdhër të dekanit ngrihet Komisioni i Ekuivalentimit të programeve.<br>Departamenti i Lëndëve Klinike përcjell për miratim propozimet për kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve në programet që ofron, kuotat e transferimit të studentëve në UE, bazuar në kapacitetet pritëse dhe |

<table>
<tr><td></td><td>akademike. Kriteret dhe kuotat e pranimit bëhen publike përmes publikimit të vendimeve të Senatit Akademik në faqen zyrtare online të UE, publikimit të kuotave e kritereve në portalin U-Albania.<br><br>Evidenca 1.1; 1.8; 1.22; 3.11, 1.20, 1,21</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</td><td>Programet e lëndëve përmbajnë informacionet e nevojshme për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara dhe me një cilësi të mirë.<br><br>Syllabuset, për secilën lëndë, ofrojnë të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me ngarkesën brenda dhe jashtë auditorit, kreditet ECTS, përshkrimin e lëndës, objektivat e lëndës, temat për secilën javë, literaturë kryesore dhe mbështetëse, rezultatet e të nxënit të lëndës, kontributi i lëndës në kompetencat e programit të studimit, metodat e vlerësimit të njohurive dhe llogaritjen e ECTS.<br><br>Syllabuset e lendeve 3.17</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</td><td>Refruar RVB dhe Takimeve në institucion dokumentacioni i programit mësimor është në përditësim të vazhdueshëm dhe në cdo fillim viti akademik dorëzohet sipas formateve të aprovuara dhe të miratura në Senatin akademik dhe arkivohet në department.<br><br>Programi i studimit ka pasur ndryshime të pakta përgjatë këtyre viteve. Megjithë përpjekjet e stafit akdemik për përmirësimin e syllabuseve vit pas viti kërkohet punë me kompetencë edhe për përmirësimin e programit të studimit.<br><br>Evidence 3.17, 3.10</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td>Njësia bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponpremin formacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve te cilët kanë gjithë informacionet e nevojshme për studentët.</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td rowspan="2">Shkalla e përmbushjes së standardit</td><td>[illegible]</td><td>Përmbushet pjesërisht</td><td>Përmbushet kryesisht</td><td>Përmbushet plotësisht</td></tr>
<tr><td></td><td></td><td></td><td>X</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi II.4<br>Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave,</td><td>Emërtimet e moduleve/lëndëve, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikat profesionale mundësojnë njohuri, aftësimin për punësim të studentëve. Në semestrin e parë zhvillohen kryesisht lëndët</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | bazë të formimit të përgjithshëm por edhe lëndët me formim specifik profesional që vazhdojnë edhe gjatë semestrit të dytë duke ndihmuar kështu në rritjen e kompetencave të studentëve.<br><br>*Evidenca 3.17* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | Programi ofron mundësi të shumta informacioni si dhe nocione bazë dhe të thelluara profesionale. Pas përfititimit të njohurive bazë studenti zhvillon në mënyë të vazhdueshme lëndë të formimit të thelluar profesional duke përfshirë këtu elementët e studimit që nga Radiologjia konvencionale dhe duke vazhduar drejt lëndëve të cilat merren me radiologjinë e avancuar si CT, MRI, Mjekësi nukleare. Të gjitha këtro njohuri i japin studentit aftësinë e nevojshme profesionale për ofrimin e shërbimit të tij në institucionet e ndryshme shëndetësore si dhe në kabinetet e radiologjisë në cdo qendër shëndetësore që i zotëron ato. Nga sa më sipër rezulton se lëndët, shpërndarja e tyre në semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.<br><br>*Evidenca 3.17* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori – praktikë është në përputhje me profilin e programit Master Profesional. Struktura e programit është krijuar duke u bazuar në përvojën e stafit, brenda dhe jashtë vendit dhe është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br><br>*Evidenca 3.17* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" parashikon lëndë themelore, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore, duke lehtësuar transferimin dhe lëvizshmërinë e studentëve. Bazuar në lëndën specifike, programi paraqet një shpërndarje të qartë të ngarkesës teorike dhe praktike për t'i mundësuar studentit procesin e mësimnxënies praktike. Për më tepër, programi i studimit ka përfshirë në kurrikulën e tij mundësi praktike në terren. Studentët duhet të fitojnë dhe përmirësojnë njohuri praktike në tema të ndryshme imazherike që mund të hasin gjatë periudhës së praktikës në një institucion shëndetësor. Pjesëmarrja e studentëve në praktika të organizuara nga Universiteti, në bashkëpunim me intitucione që ofrojnë shërbime imazherike, lehtëson punësimin e studentëve në fund të programit të studimit.<br><br>*Evidenca 3.12, 3.17, 3.9* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Syllabuset e lëndëve përditësohen në mënyrë të vazhduar por jo detyrimisht me literaturë të 5 viteve të fundit. Literatura në gjuhen shqipe e këtij programi ka problemet e veta në mungesën e teksteve në gjuhen shqipe. Pjesa më e madhe e literaturës referuese është në gjuhë te huaj.<br><br>*Evidence 2.8, 3.17* |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje edhe me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Krahas njohurive shkencore teorike synohet aftësimi praktik i studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe menaxheriale.<br><br>*Evidenca 3.17* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" dhe radioterapi i ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Niveli i njohurive është në përputhje me nivelin e ciklit të parë të studimeve, duke krijuar bazat e duhura për një studim me të thelluar dhe të përparuar në ciklin e dytë, master. Lëndët që zhvillohen dhe sidomos programet e tyre janë të tilla, që krijojnë te studentët një bazë shumë të mirë shkencore për vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e tyre në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.<br><br>*Evidence 3.16, 3.17* |
| **Konkluzione** | *Struktura e programit, është e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Syllabuset përditësohen në mënyrë të vazhdueshme. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, | Gjatë vizitës në Institucion, nga shefi departamentit të lëndëve klinike na u parashtrua se UE dhe përkatësisht edhe departamenti është konsultuar dhe ka konsideruar propozimet e institucioneve partnere dhe kryesisht ato shëndetësore ku studentët e programit të studimit realizojnë praktikat e |

| | |
|---|---|
| gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | tyre profesionale me qëllim përshtatjen e programeve të studimit me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës.<br><br>*Evidenca 1.31.1.33, 5.6, 5.7* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Universiteti i Elbasanit përfshin studentët dhe strukturat e tyre në diskutime të ndryshme. Ato janë të përfshirë në Senatin Akademik. Studentët janë të përfshirë në Këshillin studentor i cili ka rregulloren e funksionimit të tij.<br><br>*Evidenca 2.1, 2.2* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | Njësia përgjegjëse angazhohet për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit në bashkëpunim me profesionistët e shëndetit, qëndrat spitalore etj në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën mjekësore.<br><br>*Evidenca 1.3, 1.31* |
| **Konkluzione** | *Njësia bazë është e hapur ndaj propozimeve të ardhura nga strukturat shëndetësore dhe angazhohet për përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Institucioni angazhon studentët në strukturat e tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | Program i studimit Master professional në Teknik Imazheriei ka të përcaktuara kriteret edhe prioritetet e tij si dhe objektivat kryesosre të studimit dhe kërkimit shkencor bazuar edhe në ligjin e arsimti të lartë Nr 80/2015 dt 22.7.2015. Objektivat dhe prioritetet e programit të sudimit shkojnë në përputhje dhe me objektivat e Universitetit të Elbasanit.<br><br>*Evidenca 1.1, 1.17, 1.19, 1.3* |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë | Departameti i Lëndeve klinike i cili është përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit MP në Teknik Imazherie, drejton dhe koordinon veprimtarinë akademike, kërkimore, studimore dhe financiare të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | programit. Departamenti dhe koordinatori i programit, koordinojnë veprimtarinë e mësimdhënies duke respektuar lirinë akademike.<br><br>*Evidence 1.4, 1.15, 1.17* | | | |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Studentët e këtij program studimi janë të angazhuar vazhdimisht në studime apo projekte të ndryshme nëpërmjet hartimit të mikrotemave shkencore kerkimore, nëpërmjet stimulimit për të marrë pjesë në aktivitet apo konferenca profesionale si dhe nxiten të botojnë në buletinin shkencor të UE por edhe në botë.<br><br>*Evidence 1.19, 2.4, 2.5* | | | |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Departamenti dhe Universiteti mbështet realizon aktivitete shkencore si kombëtare ashtu edhe ndërkombëtare. Departamenti dhe universiteti organizojnë konferenca me pjesmarrjen e stafit akademik vendas por edhe të ftuar nga universitetet e tjera të vendit si dhe nga ato ndërkombëtare.<br><br>*Evidenca 2.3, 2.4, 2.5*<br>*RVB* | | | |
| **Konkluzione** | *Departamenti i lënëve klinike mbështet dhe koordinon kërkimin shkencor në programin e studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.7**<br>**Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Drejtimi i kërkimit shkencor, realizohet nga njesitë kryesore (Fakultet dhe Departamentet). Projektet e mëdha kërkimore, inkuraiojnë interdisiplinaritetin dhe mundësojnë koordinimin shkencor. Grupet kërkimore të kanë si qëlllim realizimin e stduimeve empirike, duke përmbushur objektivat dhe janë në koherencë me akset kërkimore individuale të kërkuesve shkencor të përfshirë në to. |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Grupet drejtuese të DLK janë një mekanizëm i rëndësishëm për kontrollin e brendshëm të cilësisë së produktit shkencor pasi, ndër të tjera, vendosin për punimet që pranohen në konferenca apo buletine shkencore si dhe orientojnë kërkimin shkencor<br><br>*Evidenca: 3.2, 3.14* |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose | DLK është angazhuar maksimalidht në organizim dhe koordinimin e aktivitetetеve shkencore brenda fakultetit por dhe FSHMT është po ashtu e angazhuar në organizimin e konferencave institucionale me pjesmarrjen |

| | |
|---|---|
| aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | e stafit akdemik dhe studentëve pjesmarrës në programet e ndryshme të studimit të UE.<br>*Evidenca: 1.29, 1.31, 3.14, 3.2* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | Porgrami i studimit formon profesionistë të fushës së imazherisë të cilët kanë përgatijen e përshtatshme dhe profesionale në këtë fushë.<br><br>*Evidenca: 1.12, 5.6, 5.7* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Nuk është kompetencë e departamentit të lëndeve klinike dhe e programit të studimit marrja e licenses dhe ndërmjetësimi për marrjen e saj.<br><br>*RVB* |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Nuk aplikohet si kriter<br><br>*RVB* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit ofron mundësi të mira kërkimore, mbështet stafin akademik dhe studentët në pjesmarrjen në koferenca të ndryshme.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Për të pasur një transmetim dhe përvetësim sa më të mire të njohurive procesi mësimor zhvillohet me leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, detyra praktike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale, punim diplome, Provim të Përgjithshëm Përfundimtar, projekte etj. Kjo formë vlerësimi, synon kontrollin e vazhdueshëm të dijeve, përgjatë semestrit, në mënyrë që studentët të identifikojnë mangësitë, vështirësitë dhe t'i plotësojnë ato, përgjatë orëve të tutoriatit akademik, përpara përfundimit të semestrit. |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik angazhohet në krijimin e një mjedisi që ofron mundësi të barabarta, pa diskriminim, për gjithë studentët në arritjen e qëllimeve të tyre akademike. Në bazë të fushësh dhe natyrës së programit të studimit si dhe feedback-ut të marrë nga studentët, personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies përvec atyre klasike si referimet me gojë të studentëve, detyra të shkurtra me shkrim (ese), projekte studimi në grup, mjete audio-vizive, zgjidhjen e rasteve studimore, etj. |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UE lidhet me trajnimin e pedagogëve. Institucioni siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore. Gjithashtu, personeli akademik ka mundësi të përfitojë nga programet e shkëmbimit të stafit me universitetet partnere perëndimore, për të shkëmbyer eksperiencë dhe njohur me praktikat e mira ndërkombëtare në fushën e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijes.<br>*Evidence 3.2* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe | Mënyra e konceptimit dhe zhvillimit të mësimit në programin e studimit ndërtohet për të garantuar mundësinë e angazhimit të vazhdueshëm të studentëve. Zhvillimi i orëve interaktive, të cilat ndërthurin shpjegimet teoriko aplikative duke u fokusuar tek ndërveprimi i vazhdueshëm pedagog – student, garantojnë zhvillimin intensiv të procesit të angazhimit të studentëve. Diskutimet, rastet studimore, puna në grupe dhe prezantimet janë disa nga instrumentet kryesore që garantojnë ndërveprimin dhe angazhimin e studentëve. Vlerësimet e kryera nga studentët apo persona të tjerë përgjegjës, shërbejnë si një tregues për mënyrën e zhvillimit të mësimit. |

| | |
|---|---|
| ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Stafi akademik nxit në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. Nëpërmjet literaturës së rekomanduar, ose artikujve shkencorë të dhënë për t'u studiuar në mënyrë të pavarur nxitet zgjerimi i konsiderueshëm i të nxënit jashtë auditorit, në mënyrë të pavarur. Pedagogët nxisin realizimin e detyrave nga ana e studentëve, gjatë orëve të seminarit, si një menyrë për të nxitur punën e pavarur dhe përfshirjen më të madhe të tyre në procesin e mësimdhënies. Për të kultivuar bashkëpunimin midis studentëve gjatë orëve të seminarit, u jepen detyra që duhet t'i realizojnë në grup. Kjo formë vlerëson jo vetëm dijet e studentëve, por edhe nxit përmirësimin e aftësive të punës në grup. |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është një strukturë autonome, e përhershme në strukturën organizative të universitetit. Ai vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore, si dhe propozon ndryshime për përmirësime të nevojshme, mbështetur në udhëzimet e sigurimit të cilësisë në hapësirën europiane të arsimit të lartë dhe legjislacionit ne fuqi. Kjo zyrë bashkëpunon me njësitë kryesore dhe bazë dhe realizon një sërë aktivitetesh të parashikuara në planin e saj të veprimit, në funksion të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies |
| **Konkluzione** | Institucioni angazhohet maksimalisht për të garantuar procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** | | | |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Sistemi i vlerësimit të njohutive në UE, ka si qëllim të vlerësimin e vazhdueshëm të njohurive të studentëve UE ka të përcaktuar kriteret dhe mënyrën e vlerësimit, në dokumentat rregullatorë të saj. Për kriteret dhe mënyrën e testimit të njohurive, studentët e rinj njihen që gjatë javës së orientimit. Mënyra e vlerësimit është rubrikë çdo syllabusi, dhe pedagogu jep udhëzimet përkatëse në auditor në fillim të zhvillimit të lëndës. Gjithashtu, studenti mund të përfitojë nga shërbimi i kujdesit dhe këshillimit të vazhdueshëm që ofrohet nga Koordinatori i departamentit dhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit.<br>*Evidenca 1.2. 1.7, 1.8, 1.15, 1.18, 1.19* | | | |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët, njihen me përmbajtjen e syllabusit dhe formën e vlerësimit, të prezantuar nga pedagogu lëndës. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm dhe në çdo syllabus është seksioni "Kontrolli i Vazhdueshëm", ku në bazë të tipologjisë së lëndës, përcaktohet dhe vlerësimi i studentëve.<br>*Evidenca 1.2. 1.7, 1.8, 1.15, 1.18, 1.19* | | | |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, gjatë provimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, zhvillohet duke mbajtur anonim emrin e studentit, nëpërmjet procesit të sekretimit, i kryer nga koordinatorja e deparatmentit, derisa pedagogu dorëzon provimet e korrigjuara në Sekretarinë Mësimore. Gjatë kryerjes së provimit në sallë me përjashtim të pedagogut të lëndës, të koordinatores që bën sekretimin e tezave dhe të monitoruesve të ngarkuar nga Departamenti, në sallën e provimit nuk lejohet që të hyjnë persona të tjerë<br>*Evidenca 1.2. 1.7, 1.8, 1.15, 1.18, 1.19* | | | |
| **Konkluzione** | *UE harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, gjatë gjithë semestrit. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa elementeve.<br><br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Institucioni në bashkëpunim me AADF (AlbanianAmerican Development Foundation) po promovon një sistem të ri vlerësimi elektronik: "Clean scoring". ClearScore është një qendër vlerësimi dixhitale që synon transparencë në vlerësimin e studentëve. Nëpërmjet këtij projekti, pedagogët mund të zhvillojnë provimet në sallat e informatikës. Deri më tani, përdorimi i këtij program është i mangët. |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Testimi i vlerësimit i përfundimtar mbështetet plotësisht në syllabusin e programit përgatitor për master.<br><br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i detyrave të kursit shoqërohet me komente për t'i evidentuar studentëve pikat e tyre të dobëta dhe mënyrën sesi ato mund të përmirësohen. Në funksion të sqarimit të studentit janë edhe seancat sqaruese, ku ata mund të shohin në detaje korigjimin e pedagogut dhe të marrin drejtpërdrejtë nga ai/ajo komente të detajuara mbi vlerësimin e tyre. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Plagjiatura dhe kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit (vendosen pikët për secilën pyetje dhe më pas mblidhen), e cila firmoset nga pedagogu që ka hartuar tezën dhe në formatin përmbledhës të vlerësimit të studentëve. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre. Në rastin e riprovimeve, duke qenë se numri i studentëve pjesëmarrës është më i ulët se në sezonet normale, afati për dorëzimin e korigjimeve është 1 (një) javë. Vlerësimi për kompontët e tjerë duhet të dorëzohen përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve. |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Studenti informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit, përmes sistemit online (LMS dhe UMIS). Brenda dy javëve nga realizimi i provimit, në orarin e caktuar për tutoriat dhe/ose këshillim akademik, pedagogu i pret studentët për të sqaruar çdo ankesë ose pretendim të mundshëm që ata mund të kenë lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, pedagogu plotëson dhe dorëzon procesverbalin përfundimtar në Sekretarinë Mësimore<br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, në rastet kur studenti ka ankesë për pikët që ka marrë në një nga komponentët e vlerësimit (provim i ndërmjetëm, detyrë kursi/detyra praktike, provim përfundimtar), ai mund t'i drejtojë Drejtuesit të Departamentit një kërkesë me shkrim, ku të parashtrojë arsyet mbi të cilat ai bazon ankesën. Me marrjen e ankesës, Drejtuesi i Departamentit ose Dekani, kur pedagogu i lëndës është vetë Përgjegjësi i Departamentit, ngre një Komision për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar. Vendimi i Komisionit, i marrë me shumicën e anëtarëve, është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi fillestar i ankimuar. Procesverbalet e vlerësimit fimosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen.<br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Konkluzione** | Procesi i kontrollit dhe vlerësimit të studentëve bazohet plotësisht në meritokracinë. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi MP në Teknik Imazherie, zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.<br>*Evidenca 1.19* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Lëndët e programit ndahen sipas 5 kategorive, ku në Kategorinë A ofrohen njohuri ndërvepruese si dhe në menaxhim. Me lëndët e Kategorisë C studentët profilizohen në një fushë me specifike. Në kategorinë D është parashikuar praktika profesionale, dhe kategoria E, punimi i diplomës.<br>*Evidenca 3.17, 3.12* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | Pedagogët përpara përfundimit të lëndës bëjnë një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Detyra e kursit që zhvillohet përpara përfundimit të lëndës është një formë e shqyrtimit të aftësisë së studentëve për të kuptuar çfarë ata kanë përfituar nga lënda.<br><br>*Evidenca 3.17, 3.12* |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Studentët mund t'i zhvillojnë aftësitë e tyre, nëpërmjet detyrave të kursit që ata zhvillojnë gjatë orëve të seminarit. Praktika profesionale është lëndë e detyrueshme që synon të lidhë njohuritë teorike dhe praktike të fituara gjatë studimeve me profesionin/et përkatës/e dhe t'i familjarizojë studentët me tregun e punës. Studentët e zhvillojnë praktikën në strukturat spitalore sipas planit të shpërndarjes së prakitkave. Lëndët e ofruara në programin e studimit, synojnë të pajisin studentët me aftësi konkrete, që të mund t'i zbatojnë dhe t'i zhvillojnë më tej në praktikat profesionale. Metodat e mësimdhënies sidomos analiza e rasteve studimore gjatë seminarit, i ndihmon t'i zhvillojnë më tepër këto aftësi. |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik, nxit bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën në grup të tyre. Gjatë orëve të seminarit, pedagogët mund të japin raste studimore, për interpretimin dhe zgjidhjen e të cilave angazhon studentët në punë në grup. Gjithashtu, sudentët angazhohen në detyra kursi. Në këtë mënyrë zhvillohen dhe aftësitë e studentëve për të punuar në grup.<br><br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | Shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus +, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitimin prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UE, dhe mund të përhapen edhe tek kolegët e tjerë në institucion. Kështu diferencat që mund të ekzistojnë me universitetet jashtë ngushtohen. Gjithashtu, mobiliteti i studentëve dhe përshtatja e tyre me mjedisin e institucioneve pritëse bëhet më e lehtë, pasi ata hasin praktika të ngjashme me çfarë kanë përjetuar gjatë studimeve në UE, por mund të sugjerojnë dhe metoda të reja të mësimdhënies, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.<br>*Evidenca 3.1, 3.2* |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi III.5<br>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Institucioni harton procedurë të posaçme për studentët të, mbrojnë diplomën. Për të përmbyllur detyrimet e tyre, studentët e programit duhet të mbrojnë diplomën. Për punimin e diplomës, jep në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, deri tek procesi i udhëheqjes së saj përmes seancave metodologjike, deri tek formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit.<br>*Evidenca 3.17, 3.12* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Të gjitha procedurat që ndiqen që në momentin e përzgjedhjes së udhëheqësit, zhvillimit të seancave metodologjike deri në prezantimin e punimit janë të përcaktuara në dokumentet rregullatorë të institucionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit përpara aplikimit për punim diplome.<br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Në rastin e studentëve të MP në Teknik Imazherie detyrimet përmbyllëse realizohen vetëm nëpërmjet mbrojtjes së punimit të diplomës, duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.<br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Udhëheqësi në seancat metodologjike duhet të trajtojë çështje të tilla si:<br>a. Përcaktimin shkencor të objektit të studimit;<br>b. Diskutimin e dobisë së punimit;<br>c. Përzgjedhjen e tematikës dhe të problematikës që do të trajtohet;<br>d. Ndërtimin e hipotezave dhe saktësimin e tyre;<br>e. Ndërtimin e strukturës së punimit;<br>f. Përcaktimin dhe shqyrtimin e burimeve parësore dhe dytësore ku do të mbështetet punimi;<br>g. Hartimin e punimit të diplomës;<br>h. Debatimin e përfundimeve të studimit etj. Udhëheqësi është garantues i cilësinë së punimit të diplomës të studentit. Diploma nuk mund të dorëzohet për mbrojtje nga studenti, pa marrë firmën e pedagogut udhëheqës.<br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Pedagogu udhëheqës gjatë seancave metodologjike trajton çështje të tilla si: trajtimin e aspekteve metodologjike, përpunimin e metodave të paraqitjes sasiore (diagrame, kurba etj); punën në terren, planifikimin, implementimin, raportimin e gjetjeve/të dhënave, etj. |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Punimi i diplomës vlerësohen me notë, e cila është mesatare e vlerësimit të anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve.<br><br>*Evidenca 1.7, 1.8, 1.15, 1.19* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Pas përfundimit të studimeve nga studenti, kopje e dokumentacionit të tij të regjistrimit arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit. |
| **Konkluzione** | *Institucioni harton dhe zbaton programin e përgatitjes përfudnimtare të studentëve bazuar dhe ne ligjet në fuqi.* |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Institucioni garanton realizomin e orëve laboratorike virtuale brenda ambjenteve të intitucionit. Për shkak të karakterit të programit të studimit është e nevojshme realizomi i praktikave në mjediset spitalore apo shëndetësore që ofrojnë shërbimin e radiologjisë.<br><br>*Evidenca 1.13* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Institucioni është angazhuar që të nënshkruajë kontrata bashkëpunimi me institucionet shëndetësore të cilat ofrojnë teknologjinë radiologjike bashkëkohore.<br><br>*Evidenca 1.13* |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Praktikat profesionale klinike harton dhe ndjek marrëveshjet e bashkëpunimit mes UE dhe institucioneve të tjera shëndetësore të cilat angazhojnë studentët. Praktikat profesionale ekuivalentohen në kredite. Për grupet e studentëve aktivizohen tutorët e praktikave.<br><br>*Evidenca 3.17* |
| **Konkluzione** | *UE është angazhuar për sigurimin e kushteve për praktikat profesionale për studentët e këtij program studimi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | I gjithë personeli akademik (me kohe të plote dhe kohe të pjesshme) i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie", është me grada dhe tituj, dhe ka kualifikimin e nevojshëm për zhvillimin e lëndëve ku është angazhuar.<br>Departamenti ka 12 anëtare personel akademik me kohë të plotë ndër të cilët 1 me titull akademik Proff. 4 personel akademik me graden PhD, dhe 7 asistente lektore me gradën Msc (ndër të cilët 4 anëtar janë në proces doktorature).<br>Në personelin akademik me kohë të pjesshme departamenti ka 1 anëtar me gradën Prof.Dr, 2 me gradën PhD dhe 26 asistente lektore me gradën Msc. Raporti i tyre është i llogaritur me ngarkesën në ore mësimore sipas urdhrit Nr.29 datë 10.09.2018.<br><br>*Evidenca 4.21. 6.5* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik (me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme) i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" përmbush kërkesat e legjislacionit në fuqi.<br>Cdo pedagog i personelit akademik efektiv mbulon ngarkesen mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.<br>Ngarkesa mësimore është e përcaktuar sipas gradës apo titullit shkencor, sipas fushës kërkimore që mbulojnë dhe pozicionit të punës, duke u shtrirë në dy semestrat akademike. Megjithëse vihet re një ngarkesë disi e madhe e personelit akademik i cili është i angazhuar në lëndët e formimit profesional si me kohë të plotë ashtu edhe me kohën të pjeshme dhe GVJ sygjeroi shtimin e pedagogëve me formim imazherik.<br>Cdo fillim viti akademik pedagoget hartojne, dorëzojnë dhe miratojne prane drejtuesit te departamentit syllabuset e lëndëve.<br><br>*Evidenca 1. 4; 4.5. 4.21. 3.16,4.20* |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin | Institucioni garantonte kontrata punësimi të rregullta për punësimin dhe mbulimin e sigurimeve shëndetësore. |

| | |
|---|---|
| e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | *Vizita në Burimet njerëzore* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Procedura për rekrutimin e stafit përmban të gjitha hallkat që duhet të ndiqen për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës mësimor dhe administrativ. Burimet njerëzore drejton të gjithë procesin. Zyra e burimeve njerëzore e fillon procesin pasi merr kërkesën nga Njësia bazë. Pozicionet e lira bëhen publike në faqen e internetit të IAL. Pasi bëhet shpallja dhe merren në dorëzim dosjet e aplikantëve, ngrihet komisioni përkatës i cili shqyrton dosjet sipas një sistemi pikëzimi të miratuar më parë. Kandidatët klasifikohen sipas pikëve të fituara dhe merret vendimi përkatës. GVJ gjykon që proceduara e rekrutimit të stafit garanton rekrutimin e personelit në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e PS.<br><br>*Evidenca 4.2, 4.3, 4.4* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | UE siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmes akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mesimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.<br><br>*Evidenca 1.14* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Referuar rregullores se institucionit dhe informacioneve të marra gjatë vizitës në vend, GVJ konstaton se në Universitetin e elbasanit, mblidhen, ruhen dhe përditësohen çdo vit akademik të dhënat personale të personelit akademik me kohë të plotë e të pjesshme si dhe ato të përsonelit ndihmës.<br><br>Ruajtja dhe përditësimi i të dhënave bëhej në dosje e personelit. Në dosjet që u shqtyrtuan nga GVJ gjatë takimit në Zyrën e burimeve njerëzore u konstatuan se në to gjendeshin të gjitha të dhënat e kërkuara dhe ato ishin të përditësuara. |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të | Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizomin e praktikave profesionale si dhe ka marrëveshje bashkëpunimiedhe me personelin shëndetësor të këtyre institucioneve. |

| | |
|---|---|
| tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | *Evidenca 1.13, 1.14* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Personeli mbikqyrës pritës ndihmon studentët në përmbushjen sa më të mirë të praktikave profesionale. Po ashtu ky personel angazhohet edhe në procesin e vlerësimit të studentëve gjatë praktikave profesionale.<br><br>*Evidenca 1.32, 1.13, 1.14* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ndjek gjithë procedurat e nevojshme per punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi edhe me institucionet e tjera shëndetësore per realizimin praktikave profesionale. Personeli mbikqyrës shëndetësor siguron cilësinë e praktikave profesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | Bazuar në RVB dhe si dhe vizitën në institucion, rezulton se UE vë në dispozicion ambjente të bollshme dhe shumë të përshtatshme për zhvillimin e procesit të mësimdhenies duke marrë në konsideratë numrin e studentëve dhe specifikën e programit të studimit. Auditoret, laboratorët, dhe mjediset ndërmjetëse ishin të gjitha funksionale.<br><br>*RVB*<br><br>*Vizita në institucion, turi i ambjenteve* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Në të gjitha ambientet mësimore të institucionit që vizitoi GVJ gjeti paisje të tilla si: tabelat interaktive, projektuesit video, kompjuterat dhe internetin të cilat ishin funksionale. Po ashtu laboratori i anatomisë ishte i pajisur me sistemin virtual të njohjes së anatomisë, pajisjet dhe instrumentët që nevoiteshin për të realizuar mesimin, Edhe laboratorët e lendëve plotësuese si informatikës apo gjuhëve të huaja ishin të pajisur me të gjitha pajisjet dhe softet për zhvillimin e procesit mësimor konform programit.<br><br>*Vizita në institucion, turi i ambjenteve*<br><br>*Takimi me studentët* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.<br><br>*Vizita në institucion, turi i ambjenteve*<br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Rëndësi i është kushtuar vizualizimit të procedurave të ekzaminimit nëpërmjet softuerëve demostrues me anën e të cilëve studentët praktikohen në modalitetet e marrjes së imazheve dhe kryerjes së ekzaminimeve të ndryshme. Laboratori i imazherisë dixhitale është fokusuar tërësisht në zbatimin e metodave inovative në imazherinë mjekësore. Në mjediset e fakultetit aksesohet interneti nëpërmjet Ëi-Fi ndërsa laboratori i informatikës u vihet në dispozicion studentëve edhe për veprimtari të tjera.<br><br>*Vizita në institucion, turi i ambjenteve*<br><br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | Institucioni ofron kushtet e përshtatshme për zhvillimin e leksioneve, seminareve apo laboratorëve të ndryshëm. Praktikat profesionale apo lëndore realizohen në istitucionet spitalore me të cilat UE ka realizuar kontratat përkatëse të bashkëpunimit.<br><br>*Evidenca 1.13* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ofron kushtet bashkëkohore të mësimdhënies në plotësimin adekuat të laboratorëve dhe kabineteve me materialin e nevojshëm didaktik.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Gjatë vizitës në Institucion GVJ konstatoi se në dispozicion të studentëve ishte biblioteka mësimore me sallë leximi të pajisura me vende leximi. Referuar RVB-së, biblioteka përmban tituj librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj të klasifikuar sipas profileve dhe disiplinave.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.11* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | Nuk ka të dhëna mbi efikasitetin e përdorimit të bibliotekës, ndërkohë që literatura bazë–dispencat menaxhohen nga sekretaria mësimore dh pedagogët.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br><br>*Evidenca 4.8, 4.11* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Ambjentet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Instititucioni i ka krijuar kushte të pershtatshem cdo studenti për aksesimin e bibliotekës fizike. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.10, 4.11* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ vlerëson që biblioteka ka tekste mësimore vetëm në gjuhë të huaj si dhe ka revista apo libra shkencorë te cilat rezultuan tekste dhe informacione bashkëkohore. U vu re prania e një numri të vogël të titujve në gjuhën shqipe të lidhura me kete program studimi. Realisht ka pak tituj shqip në lidhje me këtë program studimi.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.11* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | Institucioni ka kushtet e përstatshme për shfrytëzimin pa dallim të bibliotekës nga të gjitha degët e studimit. Po ashtu institucioni ofron barazi edhe në përdorimin e bibliotekës online. |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që | Biblioteka është e pajisur me aparatura kompjuterike dhe programe kompjuterike duke i dhën mundesi një numri të madh të studenteve ta shfrytëzojnë atë në eficience të plotë. |

| | |
|---|---|
| mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | *Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.11* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Ambjentet e bibliotekës vihen në dispozicion të studentëve në përputhje me nevojat e tyre, në përshtatje të orarit mësimor. Istitutucioni i ka krijuar kushte të pershtatshme për të përballuar kapacitetin e shfrytëzimit të saj nga ana e studentëve. Kapaciteti i bibliotekës është i mjaftueshëm për përdorimin e saj nga një numër i konsiderueshëm studentësh njëkohësisht.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.10, 4.11* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Personeli akademik si ai me kohë të plotë ashtu dhe ai me kohë të pjeshme angazhohej maksimalisht për sjelljen në dispozicion të studentëve, të literaturës së huaj për aksesimin online nga ana e tyre. Duhet theksuar se fondi fizik në gjuhë të huaj I bibliotekës është disi I reduktuar dhe ka nevojë për gjurmimin e revistave apo botimeve të reja që janë hedhur në treg ndërkohë në lidhje me degën e Teknikut të Imazherisë.<br><br>*Takimi me stafin akademik*<br>*Evidenca 4.8, 4.11, 3.19* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ofron një ambjent të përshtatshëm për bibliotekën e cila mundësohet për përdorim nga studentët GVJ rekomandon pasurimin e bibliotekes edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me ketë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të PS.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | GVJ konstaton që Universiteti I Elbasanit disponon system të menaxhimit të informacionit me të cilin administron gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre deri në diplomim.<br><br>*Evidenca 4.5* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | GVJ konstatoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.<br><br>*Evidenca 4.12, 4.13* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Të dhënat e sekretarisë mësimore, stafi akademik dhe studentët koordinohen me anë të platformës EMS dhe UNIEL.EDU.AL e cila siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente si për personelin, ashtu edhe për studentët e programit të studimit.<br><br>*Evidenca 4.12, 4.13* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Sistemi i menaxhimit ka integruar platformen e edukimit në distancë nepermjet se ciles pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë në grup ose individualisht, të përcjellin materialet e modulit, të kontrollojnë projektet apo të diskutojnë virtualisht mbi modulin mësimor.<br><br>*Evidenca 4.12, 4.13* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Programi garanton në kohë reale përcjelljen e informacionit të aksesueshëm sipas kategorive në sekretaritë mësimore, përgjegjës programi, titullari, staf akademik dhe studentë.<br><br>*Evidenca 4.12, 4.13* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Faqja zyrtare e UE është aktive në gjuhën shqipe, dhe siguron informacion ne lidhje me mesimdhenie dhe mbarevajtjen e procesit studimor ne kete program studimi.<br><br>*Evidenca 4.12, 4.13* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Institucioni ka nje system menaxhimi që siguron të dhënta për stafdin akademik dhe studentët. Institucioni disponon faqen web dhe systemin EMS për shkëmbimin e informacionit të nevojshëm si dhe për monitorimin e aktivitetit akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| Standardi IV.5<br>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Në RVB citohet se, që në momentin e planifikimit të celjes së programit të studimit, institucioni bën një parashikim të kostove dhe mundësive të mbështetjes financiare, me synim plotësimin e kushteve infrastrukturore dhe akademike për zhvillimin normal të procesit mësimor.<br><br>*Evidenca 4.14, 4.15, 2.3, 1.3* |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua edhe lidhur me financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendëse dhe të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Nga ky informacion ai mësoi që burimi kryesor i financimit ishin të ardhurat nga tarifat e studentëve ndërsa fondet e tjera lidheshin me të ardhurat nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shpërndarja e këtyre fondeve bëhej nga Bordi i Administrimit bazuar në zërat e miratuara në buxhet.<br><br>*Evidenca 4.14, 4.15, 2.3, 1.3* |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Plani i financimit përshkruan të gjitha kostot e një programi studimi. Ai përmban financimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturore, pajisjet, materialet e konsumit për zhvillimin e laboratorëve dhe praktikave mësimore e spitalore, fondin për pasurimin e bibliotekës dhe aksesin në bibliotekat on-line, si dhe mundësitë e mbështetjes financiare të projekteve të UE.<br><br>*Evidenca 4.14, 4.15, 2.3, 1.3* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Cdo fund viti akademik hartohen pasqyrat financiare, ku përcaktohet gjëndja financiare dhe realizimi i Projekt - Buxhetit të UE. Institucioni kryen auditim periodik. Institucioni raporton deri në nivle të njësisë bazë në lidhje realizimine buxhetit të vitit paraardhës.<br>*Evidenca 4.14, 4.15, 2.3, 1.3* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Cdo vit institucioni përpilon pasqyrat financiare. Nga raportet financiare të UE dëshmohet se, institucioni ka një gjëndje të qëndrueshme financiare pa detyrime ndaj të tretëve Qëndrueshmëria ekonomike, citohet në RVB, i ka shërbyer rritjes së cilësisë, shtimit të laboratorëve dhe përmirësimit të infrastrukturës së UE.<br>*RVB*<br>*Evidenca 4.14, 4.15, 2.3, 1.3* |
| **Konkluzione** | *Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit i cili përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | Institucioni garanton nëpërmjet statutit të Universitetit të Elbasanit dhe Rregulloreve të institucionit, zbatimin e politikave dhe procedurave në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prej tyre vijon zbatimi i ligjit në Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Departamentit, Rregulloren e Programit.<br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Rregullorja e programit përcakton me ligj procedurën e pranimit, të drejtat dhe detyrimet e studentit, diplomimin, duke hartuar politika që garantojnë barazinë e studentëve.<br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit. Pranimi i studentëve bazohet në kriteret e percaktuara nga MASR për pranimin në ciklin e dytë të studimit respektuar renditjen sipas pikëzimit. Sekretaria mësimore mban regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi online në portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretaria firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.<br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretari, përkatësisht dosjeve të studenteve, GVJ evidentoi që ato ishin të plota dhe konform rregulloreve në fuqi. Kushtet dhe procedura e transferimit dhe njohjes së krediteve bëhen me dije nga koordinatori i programit. Ndërsa kriteret dhe procedurat e përparimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit janë përgjegjësi e pedagogëve dhe lehtësohen e mbështeten nga tutori i grupit. Informacioni në lidhje |

| | |
|---|---|
| | me procedurat e përzgjedhjes, njojes së krediteve, vlerësimi I dijeve etj është lehtësisht I kuptueshëm nga publiku.<br><br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Para cdo fillim viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit organizohet fushata e informimit. Stafi i ngarkuar për informim pret dhe sqaron të interesuarit me informacionin e nevojshëm për pranim. Në afatet e përcaktuara për aplikimet, pranë ambjenteve të Universitetit stafi i ngarkuar për informim pret dhe jep gjithë informacionin e nevojshëm për pranim.<br><br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Para fillimit të vitit akademik institucioni organizon fushatën e imformimit për të gjitha programet e studimit edhe për studentët me aftësi të vecanta, pakicave dhe shtresave të margjinalizuara.<br><br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | Bazuar në kriteret kombëtare dhe propozimit të ardhur nga njësia bazë me vendim senati shpallen kriteret dhe modalitetet e pranimit të studentëve nga shtetet e tjera, të cilat u bëhen me dije aplikantëve përgjatë periudhës së informimit dhe aplikimit<br><br>*Evidenca 1.1., 1.2, 1.3,1.4, 1.7, 5.3, 5.4, 5.5* |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Strategjia e universitetit është edhe hartimi I politikave ndihmëse nëpërmjet bursave për studentët në nevojë apo student të kategorive të vecanta. |
| **Konkluzione** | *Institucioni zbaton procedurat për pranim, përzgjedhje, transferim të studentëve në programin e studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të | GVJ konstaton se, njohjen me rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit të dijeve, konvertimin e pikëve në |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | notë si dhe kriteret për të kaluar në vitin pasardhës e kryen përgjegjësi i programit i cili e ka detyrim institucional.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.7, 1.8* | | | |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | Referuar RVB-së kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme dhe transferimit të krediteve përcaktohen në Rregulloren e UE dhe specifikohen në Rregulloren e programit të studimit. Ekuivalentimi dhe njohja e krediteve të fituara nga kandidati prej studimeve të mëparshme bëhet nga Komisioni i Ekuivalentimit, i ngritur nga Dekani i Fakultetit.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.7, 1.8* | | | |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Në syllabuset e moduleve përcaktohen elementët e vecantë të vlerësimit të njohurive, pikëzimi e konvertimi në notë. Studentëve iu bëhet me dije nga pedagogu përgjegjës për modulin, ditën e parë të mësimit.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.7, 1.8* | | | |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Në fillim të ciklit të studimeve, Përgjegjësi i programit informon studentët mbi procedurën e diplomimit, duke u këshilluar me pedagogët, studentët plotësojnë formularin përkatës.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.7, 1.8* | | | |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Cdo fillim viti, studentëve iu vihet në dispozicion informacioni mbi programin e studimit nëpërmjet faqes zyrtare, katalogut të shkollës, fletëve informuese, sekretarisë, stafit akademik dhe përgjrgjësit të programit.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.7, 1.8* | | | |
| **Konkluzione** | *Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **[illegible]** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | GVJ vëren se, studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin e procesit mësimor, orët e teorisë dhe praktikës, si edhe sezonet e provimeve nëpërmjet kalendarit akademik të prezantuar nga Përgjegjësi i programit.<br><br>*Evidenca 4.12,.4.13,* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Në lidhje me planin mësimor, lëndët dhe modulet, studentëve u vihet në dispozicion katalogu i shkollës, si dhe tabelat informuese në auditoret e leksioneve. Kjo bën që ata të jenë të mirëinformuar për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.<br><br>*Evidenca 4.12,.4.13,* |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe ofron mbështetje institucionale nëpërmjet Zyrës së Karrierës, e ngritur enkas për këtë qëllim. Zyra zhvillon aktivitete të edukimit në vazhdim dhe mban kontakte me studentë e të diplomuar për ndjekjen e karrierës së tyre profesionale. Referuar RVB, kjo zyrë edhe e trajnon edhe e mbështet studentin në krijimin e dokumentacionit sa më të përshtatshëm për të konkuruar në tregun e punës. Zyra ndërmjetëson kontaktet dhe i finalizon ato.<br><br>*Evidenca 4.12,.4.13,* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentët informohen dhe përditësohen me organizimin e procesit mësimor nëpërmjet orareve mësimore, orareve të praktikave etj<br><br>*Evidenca 4.12,.4.13,* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | GVJ konstaton që informacioni në lidhje me programin e studimit Master Profesional në "Teknik Imazherie" është i plotë në platformën online të Universitetit<br><br>*Evidenca 4.12,.4.13,* |
| **Konkluzione** | *Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi V.4<br>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Instituciono i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Institucioni, disponon në sekretarinë mësimore, statistikat vjetore me numrin e studentëve dhe të diplomuarve për cdo program studimi.<br>Referuar vizitës në sekretarine mësimore u konstatua se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për tre vitet akademike ishte:<br>Viti akademik 2020-2021-- 18 studentë<br>Viti akademik 2021-2022-- 23 studentë<br>Viti akademik 2022-2023-- 24 studentë<br>*Evidenca 1.16, 1.34*<br>*Tabelat RVB, Vizitë në sekretarinë mësimore* |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Universiteti, disponon gjithashtu, dokumentacionin vjetor me numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, ngrirjen e studimeve, largimin e studentëve gjatë ciklit të studimit. Informacioni ruhet në kohë reale dhe menaxhohet në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave nga sekretaria mësimore. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve në formën e dokumentacionit fizik (procesverbale, regjistra), si edhe në formën elektronike.<br>*Evidenca 1.16, 1.29*<br>*Tabelat RVB, Vizitë në sekretarinë mësimore* |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Në sistemin e brendshëm të menaxhimit të të dhënave, në kushte të sigurisë së plotë, kanë të drejtë dhe detyrim të hedhin dhe modifikojnë informacionin persona të autorizuar në varësi të detyrës (sekretaria, dega mësimore, tutori akademik) dhe mund të hyjnë pa të drejtë manipulimi, një kategori e caktuar personash të autorizuar.<br>*Evidenca 1.16, 1.34*<br>*Tabelat RVB, Vizitë në sekretarinë mësimore* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | Institucioni realizon kontrolle periodike në njësinë përgjegjëse të menaxhimit duke vlerësuar dokumentacionet si dhe saktësinë e dokumentave në lidhje me studentët dhe aktivitetin përkatës të tyre<br><br>*Evidenca 1.16, 1.34*<br>*Tabelat RVB, Vizitë në sekretarinë mësimore* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Referuar RVB-së, institucioni harton një raport vjetor gjithëpërfshirës, për të gjitha njësitë dhe programet që ofron. Në këtë raport analizohet edhe cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje dhe sugjerohen masa për përmirësimin e cilësisë.<br><br>*Evidenca 1.16, 1.34*<br>*Tabelat RVB, Vizitë në sekretarinë mësimore* |
| **Konkluzione** | *Institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Statuti rregullorja e UE, parashikojnë përfshirjen e studentëve në hallkat vendimarrëse dhe këshilluese, në plotësim të kërkesave të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".<br><br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.13, 5.17*<br><br>*Takimi me stafin, Takimi me studentët* |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, | Studentët organizohen në Senatin Akademik, me një përfaqsues të tyre, si dhe në komisione të tjera me përfaqësues studentësh si këshilli studentor, komisioni për standartet e cilësisë, komisioni i kurrikulave, GVB, komisioni i kërkimit shkencor. Përfshirja e studentëve në procese të rëndësishme akademike garantohet me pjesëmarrjen e tyre në |

| | |
|---|---|
| të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | komisione, si: komisioni i kurrikulave, NJSBC, komisioni i kërkimit shkencor.<br><br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.13, 5.17*<br>*Takimi me stafin, Takimi me studentët* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Studentët gëzojnë të drejtat e tyre të përcaktuara në dokumentat rregullatorë. Të drejtat e studentëve respektohen nga stafi akademik, administrativ, sekretaria dhe drejtuesit e institucionit. Ata kanë të drejtë të njihen me tezën e tyre të provimit, të komentojnë rezultatin dhe të ndjekin të gjitha shkallët e ankimimit për rivlerësim.<br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.13, 5.17*<br>*Takimi me stafin, Takimi me studentët* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive. Është në filozofinë e institucionit që studentët të vlerësohen drejt dhe të përvetësojnë sa më shumë dije.<br><br>*Evidenca 1.1, 1.2, 1.3, 2.1, 2.2, 3.13, 5.17*<br>*Takimi me stafin, Takimi me studentët* |
| **Konkluzione** | *Institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Gjatë vizitës në institucion GVJ kërkoi informacione më të detajuara lidhur me procedurat dhe njësitë për informimin e studentëve dhe shërbimet për to në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të Universiteteve. Në përgjigje të këtij interesimi Përgjegjësi i Departamentit na informoi hollësisht lidhur me kërkesën tonë.<br><br>*Vizita ne institucion*<br>*Evidenca 4.13, 5.16, 5.17,* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | GVJ konstatoi që në Universitetin e Elbasanit është ngritur dhe funksionon infrastruktura e posaçme organizative dhe logjistike. Studenti informohet vazhdimisht dhe shërbehet sa herë ai e kërkon shërbimin. Në Universitetin e Elbasanit Zyra e Informimit dhe Keshillimit të Karierës kryen të gjitha shërbimet e këshillimit të karierës.<br><br>*Vizita ne institucion*<br>*Evidenca 4.13, 5.16, 5.17,* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Sipas tij informacionet bazë studentët i merrnin nga faqja zyrtare e institucionit e cila është vazhdimisht e përditësuar. Po kështu edhe zyrat përkatëse brenda institucionit (zyra e kurrikulave, zyra e këshillit të karrierës) informojnë në mënyrë të vazhdueshme studentët dhe u ofrojnë atyre të gjitha shërbimet e kërkuara. Nga ana tjetër kjo Zyrë mirëpret studentët në mënyrë periodike që ata të informohen lidhur me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Duke ndërmjetësuar interesimin dhe potencialet e të dyja palëve ajo realizon si kërkesat e tregut të punës ashtu edhe punësimin e studentëve të diplomuar.<br><br>*Vizita ne institucion*<br>*Evidenca 4.13, 5.16, 5.17,* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Kjo zyrë gjithashtu mblidhte, përpunonte dhe ruante të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit edhe të studentëve të PS Master Profesional në "Teknik Imazherie". Këto të dhëna ajo ua vinte në dispozicion studentëve nëpërmjet faqes zyrtare në interne.<br><br>*Vizita ne institucion*<br>*Evidenca 4.13, 5.16, 5.17,* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | UE ka hartuar udhëzues për zhvillimin e metodave innovative të mësimdhënies.<br>Sektori I kurrikulave dhe NJSBC zhvillojnë pyetsorët e studentëve për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim informimin mbi resultatet dhe rekomandimet.<br><br>*Evidenca 6.1, 1.19, 1.20,3.13, 3.14, 5.15* |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | UE ka hartuar udhëzues për zhvillimin e metodave innovative të mësimdhënies.<br>Sektori I kurrikulave dhe NJSBC zhvillojnë pyetsorët e studentëve për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim informimin mbi resultatet dhe rekomandimet.<br><br>*Evidenca 6.1, 1.19, 1.20,3.13, 3.14, 5.15* |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | Studentët kontribuojne në mënyrë direkte me vlerësimin e tyre mbi institucionin dhe cilësinë e mësimdhënies. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audiencë të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet.<br><br>*Evidenca 6.1, 1.19, 1.20,3.13, 3.14, 5.15* |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Ne fund të cdo viti akademik përpilohet raporti mbi rezultatet e pyetësorit studentor mbi vlerësimin e Cilësisë së Mësimdhënies për Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre. Ne Komisionin e Përhershëm për Standardet e Cilësisë, një anëtar është përfaqësues i studentëve.<br><br>*Evidenca 6.1, 1.19, 1.20,3.13, 3.14, 5.15* |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Institucioni vlerëson rezultatet e marra nga pyetsorët te cilet publikohen me qëllim evidentimin e shembujve më të mirë me qëllim final rritjen e cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*Evidenca 6.1, 1.19, 1.20,3.13, 3.14, 5.15* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Referuar RVB, si edhe takimit me përfaqësues të NjSBC, u cilësua se: Bazuar në Nenin 103 të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërise: "Institucionet e Arsimit të Lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe pocedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë". Struktura dhe funksionimi i Njësisë së Sigurimit të Brendshëme të Cilësisë (NjSBC) përcaktohen në Statutin e Institucionit të Arsimit të Lartë. Në zbatim të këtij neni, Senati Akademik i UAL ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë.<br><br>Institucioni ka ngritur një Sistem të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili funksionon në bazë të elementëve të mëposhtëm:<br>• Mbështet dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë;<br>• Bashkërendon komunikimin midis strutkurave të ndryshme në nivel institucional;<br>• Interpreton detyrimet kombëtare dhe europiane të sigurimit të cilësisë;<br>• Asiston në hartimin e pyetsorit;<br>• Propozon masa pëer përmirësime të nevojshme që lidhen me garantimin e cilësisë;<br>• Miraton rregulloren për garantimin e standarteve;<br><br>*Evidenca 5.13, 5.16* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Në përbërje të NjSBC përfshihen personeli akademik dhe një përfasques i studentëve. Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet përmes proceseve te vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.<br><br>*Evidenca 5.13, 5.16* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit. | NjSBC monitoron dhe vlerëson procedurat dhe standartet, duke analizuar dhe krahasuar rezultatet në bazë të treguesve të cilësisë, në bazë të kritereve dhe standarteve të paracaktuara për krijimin e kulturës së cilësisë në institucion.<br><br>*Evidenca 5.13, 5.16* |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit. | NjSBC përdor tregues të matshëm të mësimdhënies me qëllim pasqyrimin e gjendjes aktuale të mësimdhënies, dobësive të saj etj. Duke vlerësuar këto tregues intittucioni synon nxitjen e rritjes së cilësisë së mësimdhënies.<br><br>*Evidenca 5.13, 5.16* |
| **Konkluzione** | *Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi VI.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. | Vlerësimi i cilësisë së programit të studimit dhe përmirësimi i tij kryhet nga njësia ofruese e programit të studimit dhe NjSBC nëpërmjet ristrukturimit të programit të studimit sipas përcaktimeve ligjore dhe nënligjore; standarteve dhe kritereve të studimeve; cilësisë dhe numrit të nevojshëm të stafit akademik; politikës së përzgjedhjes së teksteve universitare dhe aplikimit të teknologjisë bashkëkohore; infrastukturës mësimore, monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm dhe akreditimit. |

| | |
|---|---|
| Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | *Evidenca 5.15, 4.19,3.14, 3.13, 1.34* |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Në raportet e vlerësimit përfshihen rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, arritjet më të mira si dhe veprimet e marra për përmirësimin e cilësisë si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim shkencor.<br><br>*Evidenca 5.15, 4.19,3.14, 3.13, 1.34* |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | UE përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit. Vetëvlerësimi është një proces sistematik i mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave sasiore dhe cilësore nga burime të ndryshme, me qëllim përmirësimin e mësimnxënies së studentëve dhe vlerësimin e përmbushjes së standarteve akademike.<br><br>*Evidenca 5.15, 4.19,3.14, 3.13, 1.34* |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | UE përdor metologji vlerësimi, instrumentat matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbajtjen e programit të studimit si Treguesit e performancës akademike apo pyetësorin e studentëve. Strukturat e ndryshme si Dekani i Fakultetit, përfaqësuesi i NjSBC në programin e studimit mbikqyrin zbatimin e programit mësimor. Raporti i hartuar nga NjSBC i kalon Rektorit, i cili e shtron në Senatin Akademik për të marrë masat dhe vendimet e duhura për përmirësimin e performancës dhe cilësisë. NjBSC cdo fundviti akademik publikon Raportin Vjetor, në përmbajtjen e të cilit përshkruhet edhe plani i masave për përmirësimin e treguesve me vlerë të ulët.<br><br>*Evidenca 5.15, 4.19,3.14, 3.13, 1.34* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Institucioni ndjek hapa konsistentë në monitorim dhe vlerësim të programit të studimit për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e kurrikulës.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | Strukturat institucionale si Departamenti, Fakulteti, Rektorati, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Standardet për sigurimin e cilësisë së institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brëndshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.<br><br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 2.** Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | UE garanton përfshirjen e anëtarëve të stafit të UE-së si dhe të studentëve të këtij programi studimi në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit nëpërmjet Rregullores se UE, Rregullores së FSHMT-se, Rregullores se NJSBC.<br><br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit. | Pjesë e grupit të punës janë anëtarë të njësisë bazë dhe kryesosre përgjegjësepër këtë program, anëtarë akademik dhe nidhmës akademik.<br><br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj | Përfshirja e personelit të brendshëm në procesin e ciklimit është bërë në respect të ruajtjes së integritetit të gjithësecilit dhe duke shmagur cdo lloj pabarazie mes personelit akademik apo studentëve. |

| | |
|---|---|
| diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | *Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | UE inkurajon pjesëmarrjen e studentëve në jeten institucionale. Pjese e rëndesishme e procesit të vleresimit të brëndshëm janë vleresimet e të ish diplomuarve, të eksperteve, të bashkepunetoreve në hartimin e programeve të studimit apo syllabuseve<br>Në kuadër të akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit që mbulojnë departamentet e FSHMT-së, janë zhvilluar takime me grupin e Vlerësimit të Jashtëm, i përbere nga eksperte ndërkombëtarë dhe vendas, të perzgjedhur nga ASCAL dhe Bordin e Akreditimit. Ata kanë zhvilluar takimet dhe verifikimet e nevojshme, duke përmbyllur një proces, i cili prej një viti kishte filluar në UE.<br><br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Konkluzione** | *Institucioni përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | Nëjsia e brëndshem e sigurimit të Cilesise është angazhuar fort në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve që paraqiten gjatë mësimëdhenies apo auditimet e ndryshme në strukture.<br>Institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.<br><br>*Evidenca 4.19, 5.13, 5.16.*<br>*Takimi me NJSBC* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe | Njësia e sigurimit të brëndshem të cilesise realizon pyetsore të pervitshem ne lidhje me procesin e mesimdhenies. Rezultatet mblidhen përpunohen dhe raportohen ne faqen online të fakultetit. Cdo student mund të aksesoje këtë raport. |

| | |
|---|---|
| legjislacionin për të dhënat personale. | *Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | Politikat dhe Procedurat e Sigurimit të Cilësisë janë zyrtarisht të miratuara, të dokumentuara dhe janë rishikuar dhe zhvilluar si përgjigje ndaj ndryshimeve kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përmirësimin e vazhdueshëm.<br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, në bashkëpunim me fakultetet, organizon seanca informimi për studentët në lidhje me rëndësinë e rezultateve të vlerësimit të pedagogut të lëndës për përmirësimin e programit të studimit.<br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Në përgjithesi rezultatet kanë evidnetuar problematika por ato kanë qënë jo madhore dhe nuk kanë ndikuar në procesin akademik.<br>*Evidenca 5.16, 1.1, 1.3, 4.19*<br>*RVB* |
| **Konkluzione** | *Institucioni zbaton politika për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe synon trasparencën e tyre .* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Bachelor "Teknik Imazherie" ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Aleksander Xhuvani"**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi i studimeve Bachelor në "Teknik Imazherie" zhvillohet nëkushtet e një infrastrukture, ku të gjitha ambientet sidomos auditorët e mësimdhënies janë dizenjuar në plotësim të standarteve për mësimin.
2. Personeli akademik i këtij program studimi, ndjehet i vlerësuar dhe i përkushtuar në angazhimin e tij për të arritur rezultate sa më të mira dhe për të merituar vlerësimin e studentëve.
3. Infrastruktura dhe logjistika ne funksion te programit te studimit eshte mjaft bashkekohore dhe ne funksion te programit te studimit në pjesën kryesore të saj.
4. Marrëveshjet dhe bashkepunimet në funksion te programit te studimit vecanerisht me institucione shëndetësore dhe klinika private janë një element i rendësishëm në fushën që ofron ky program studimi.

**Pika të dobta**

1. Ka nevojë për përmirësime strukturore në programin e studimit bazuar në plotësimin e saktë tëgjithë elementëve të veprimtarive formuese. [Standardi II.1/Kriteri 3]
2. Ka nevojë të implementohen metodat e avancuar, elektronike të kontrollit të dijeve të cilat ruajnë dhe anonimatin dhe shmangin konfliktet. [Standardi III.2/Kriteri 1]
3. Rekomandohet pasurimin e bibliotekes edhe me tituj apo tekste shqip të cilat lidhen me ketë program studimi, si dhe përditësimin e fondit ekzistues të saj në mbështetje të PS. [Standardi IV. 3/Kriteri 4]

**Rekomandime**

1. Instutucioni të angazhohet në përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit.
2. Institucioni të gjejë mekanizmat për pajisjen me literaturën e nevojshme (shqiptare dhe të huaj) të viteve të fundit në funksion të programit të studimit.
3. Institucioni të angazhohet në rritjen e numrit të studentëve për të garantuar qëndrueshmërinë afatgjatë të programit të studimit.

**<u>Evaluation's conclusions for the second cycle study program Bachelor "Radiologic Technologist" provided by the Higher Education Institution "Aleksander Xhuvani University"</u>**

**Strengths and affirmations**

1. The Study Program Bachelor in "Radiologic Technologist" takes place under the conditions of an infrastructure, where all the premises, especially the teaching auditoriums, are designed to meet the standards for learning.
2. The academic staff of this study program feels valued and dedicated in its commitment to achieve the best possible results and to deserve the students' evaluation.
3. Infrastructure and logistics in function of the study program is quite contemporary and in function of the study program in its main part.
4. Agreements and collaborations in the function of the study program, especially with health institutions and private clinics, are an important element in the field offered by this study program.

**Weaknesses**

1. There is a need for structural improvements in the study program based on the correct completion of all elements of formative activities. [Standard II.1/Criterion 3]

2. There is a need to implement advanced, electronic knowledge control methods that preserve anonymity and avoid conflicts. [Standard III.2/Criterion 1]

3. It is recommended to enrich the library with titles or Albanian texts related to this study program, as well as updating its existing fund in support of study program. [Standard IV.3/Criterion 4]

**Recommendation**

1. The institution should engage in improving the curriculum of the study program.

2. The institution should find the mechanisms for equipping with the necessary literature (Albanian and foreign) of recent years in function of the study program.

3. The institution should engage in increasing the number of students to guarantee the long-term sustainability of the study program.

## Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |